

Kryeministri serb, Aleksandar Vuçiq, tha se debati në Kuvendin e Kosovës mbi pronësinë e Trepçës është shtyrë për ditën e mërkurë, përkatësisht më 21 janar.

Kjo, sipas kreut të qeverisë serbe, është si rezultat i ndryshimeve të Qeverisë së Serbisë për të zgjedhur problemin e pronësisë së Trepçës.

Qeveria e Kosovës vendosi sot të tërheq amendamentet nga procedimi parlamentar të projekt-Ligjit për Ndërmarrjet Publike, i cili parashihte një ligj të veçantë për kombinatin "Trepça", transmeton Telegrafi.

“Tema rreth pronave në Kosovë nuk është hapur ende, ndërsa qeveria serbe kërkon që kjo të diskutohet sa më parë, por jo që pronat të konfiskohen brenda natës”, tha kryeministri serb Vuçiq.

I pyetur të komentojë se si çfarë mendon komuniteti ndërkombëtar rreth kësaj teme, Vuçiq pohoi se beson që bashkësia ndërkombëtare është neutrale në lidhje me temën e Trepçës. /Telegrafi/